Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sallahu shpk" të datës 05.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sallahu shpk" të datës 05.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sallahu shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 05.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A – Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pika 1 – Buldozher, me peshë min. 14 ton – max. 16 ton

Kërkesa kufizon pjesëmarrjen e operatorëve që posedojnë buldozerë me peshë nën 14 ton ose mbi 16 ton, ndonëse pajisjet e tilla mund të jenë të përshtatshme për punimet e planifikimit dhe formësimit të terrenit.

Në paramasë parashihen gërmime në sasi prej 17,896.18 mł, formësimi dhe ngjeshja e nënbazës, si dhe punime të tjera tokësore. Këto sasi mund të kërkojnë buldozer, por nuk e dëshmojnë vetvetiu nevojën për një interval kaq të ngushtë të peshës.

Kërkojmë që intervali 14–16 ton të largohet , dhe të vendoset kapaciteti prej min 14 ton, pa kufizim të panevojshëm të peshës minimale dhe maksimale.

Pika 2 – Ekskavator për gërmim, me peshë min. 26 ton – max. 30 ton

Paramasa përfshin gërmime të konsiderueshme, por nuk rezulton nga sasitë e paraqitura se gërmimi duhet patjetër të kryhet me ekskavator brenda intervalit kaq të ngushtë prej 26–30 ton.

Përcaktimi i një kategorie të ngushtë të peshës përjashton makineri me kapacitet më të vogël ose më të madh, të cilat mund t'i realizojnë punimet në mënyrë të përshtatshme.

Kërkojmë që të lejohet ekskavator me kapacitet të përshtatshëm për gërmimet e parapara, duke larguar intervalin 26–30 ton dhe duke zëvëndësuar në min 26 ton .

Pika 3 – Ekskavator, me peshë min. 20 ton – max. 26 ton

Në këtë pozicion kërkohet ekskavator , sërish me kapacitet në interval të ngushtë prej 20-26t.

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 20 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 4 – Ekskavator me zinxhir, pllug dhe riper, me peshë 23–25 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 23 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 5 – Dy ekskavatorë me peshë min. 5 ton – max. 8 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 5 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 6 – Ekskavator me zinxhir gome, me peshë min. 4 ton – max. 5 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 4 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 7 – Sharrë prerëse hidraulike që montohet në ekskavator, me peshë max. 60 kg

Kërkesa përcakton një pajisje specifike të montueshme në ekskavator dhe një peshë maksimale prej 60 kg. Në paramasë parashihet prerja e asfaltit, betonit dhe materialeve të tjera të ngurta, por nuk dëshmohet se prerja duhet të realizohet pikërisht me një sharrë hidraulike të montuar në ekskavator.

Kërkojmë që të lejohet përdorimi i prerëses së asfaltit ose betonit, të montueshme apo të pavarur, , pa kufizim të panevojshëm të peshës dhe mënyrës së montimit.

Pika 9 – Ngarkues, me peshë min. 20 ton – max. 24 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 20 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 10 – Ngarkues, me peshë min. 12 ton – max. 16 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 12 ton, pasi

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 11 – Ngarkues me lugë dhe fshesë, me peshë min. 6.5 ton – max. 8.5 ton
Kërkesa kombinon dy funksione të ndryshme në të njëjtën makineri: ngarkimin me lugë dhe pastrimin me fshesë. Në paramasë ka punime pastrimi dhe demolimi, por duhet të sqarohet pse është e domosdoshme që të dy funksionet të kryhen me të njëjtën pajisje dhe brenda këtij intervali peshe.
Kërkojmë po ashtu largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 6 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 12 – Ngarkues me lugë, fshesë dhe pirun, me peshë min. 5 ton – max. 6 ton
Kërkesa për një ngarkues tjetër, me tri pajisje të kombinuara dhe interval peshe prej vetëm një ton diferencë është krejtësishtë e kundërligjshme dhe kërkojmë të ndryshohet, të kërkohet ngarkues me lugë min 5ton.
Pika 13 – Pajisje për shtrimin e bankinave dhe rigollave me GPS dhe nivelizues automatik, e montuar në ngarkues 1–1.5 ton
Kërkojmë që kërkesa për GPS, konfigurimin e montimit dhe intervalin 1–1.5 ton të hiqet dhe të riformulohet kërkesa në bazë të nevojave të projektit ,sepse shihet qartë se është kërkesë e vendosur për të favorizuar një OE të caktuar , andaj në mënyrë që kërkesa t'i përshtatët nevojave të projektit dhe të jetë ne pajtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik të formulohet në ;
Pajisje për shtrimin e bankinave dhe rigollave min 1ton.
Pika 15 – Makinë për sheshimin dhe nivelizimin e rrugëve, me peshë min. 4 ton – max. 6 ton
Funksioni i sheshimit dhe nivelizimit mund të realizohet nga makineri të ndryshme, varësisht nga lloji dhe sipërfaqja e punimit. Përcaktimi i një intervali prej vetëm 4–6 ton nuk arsyetohet nga projekti dhe paramasa.
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 4 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 16 – Grejder mbi 16 ton me librezë
Kërkesa për pajisjen me librezë të regjistrimit për grejderin nuk është e arsyetuar, pasi bëhet fjalë për makineri të rëndë ndërtimore, e cila përdoret për realizimin e punimeve në terrene dhe objekte ndërtimore, dhe jo për qarkullim të zakonshëm rrugor si mjet motorik i regjistrueshëm.
Për më tepër, kërkesa për librezë të regjistrimit, në rastet kur kjo kategori e makinerive nuk i nënshtrohet detyrimit për regjistrim sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, paraqet kërkesë të panevojshme dhe kufizuese për operatorët ekonomikë, duke pamundësuar dëshmimin e pronësisë dhe disponueshmërisë së makinerisë përmes dokumentacionit tjetër përkatës.
Andaj, kërkojmë që kërkesa për librezë të regjistrimit të largohet dhe të lejohet dëshmimi i posedimit ose disponueshmërisë së grejderit përmes faturës së blerjes, dokumentit doganor (DUD), kontratës së qirasë apo dokumenteve të tjera përkatëse që dëshmojnë posedimin dhe identifikimin e makinerisë
Pika 18 – Cilindër teledirixhues, maksimumi 2 ton
Kërkesa që cilindri kompaktues të jetë patjetër i tipit teledirigjues paraqet kufizim të panevojshëm të specifikimeve teknike, pasi funksioni i cilindrit i cili është ngjeshja dhe kompaktimi i shtresave të materialit gjatë realizimit të punimeve ndërtimore,realizohet pa asnje problem permes komandimit nga operatori, sepse nuk ka asnje arsyje qe të jetë

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

teledirigjues kur nuk ka asnje terren të rrezikshëm apo të pa përshtatshëm.
Pika 19 – Cilindër me vemza për ngjeshje, me peshë 21.5–22.5 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 20 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 20 – Cilindër me vemza për ngjeshje, vibrues, me peshë 15.5–17.5 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 15 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 21 – Cilindër vibrues për ngjeshje, me peshë 17–19 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 17 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 22 – Cilindër vibrues për ngjeshje, me peshë 10–12 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 10 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 23 – Cilindër jo vibrues, me peshë 11–13 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 11 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 24 – Cilindër jo vibrues, me peshë 17–19 ton
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 17 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 26 – Gjysmërimorkio për pastrimin e rrugëve, me dy pompa dhe presion minimal 220 bar
Ky pozicion përcakton një konfigurim shumë specifik: gjysmërimorkio për pastrim, dy pompa dhe presion minimal prej 220 bar. Në paramasë parashihen punime të pastrimit dhe demolinit, por duhet të sqarohet se cilat punime kërkojnë pikërisht këtë konfigurim dhe këtë nivel presioni.
Kërkojmë që të arsyetohet teknikisht nevoja për dy pompa dhe presionin minimal prej 220 bar, ose që kërkesa të riformulohet sipas rezultatit të pastrimit që duhet të arrihet, duke lejuar pajisje ekuivalente.
Pika 27 – Gjysmërimorkio kiper me kran, me gjatësi minimale 6 m dhe peshë maksimale 1.2 ton
Formulimi i kësaj kërkese ngre paqartësi teknike: nuk është e qartë nëse pesha maksimale prej 1.2 ton i referohet kranit, ngarkesës së tij apo vetë pajisjes. Po ashtu, nuk sqarohet pse kërkohet gjatësi minimale prej 6 metrash dhe çfarë materiali duhet të transportohet me këtë konfigurim.
Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë parametrat teknikë dhe funksionin konkret të pajisjes, si dhe të largojë kufizimet që nuk janë të domosdoshme për realizimin e punimeve.
Pika 29 – Kamion me fshesë dhe spërkatës për emulsion
Paramasa përfshin punime asfaltimi dhe spërkatje me emulsion në sipërfaqet e parapara. Prandaj, pajisjet për spërkatjen e emulsionit mund të jenë të nevojshme. Megjithatë, nuk është e qartë pse spërkatësi duhet të jetë i integruar pikërisht në kamionin me fshesë. Kërkojmë që të lejohet përdorimi i pajisjeje të veçantë për spërkatjen e emulsionit, ose i zgjidhjeve të tjera ekuivalente që sigurojnë pastrimin e sipërfaqes dhe aplikimin uniform

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

të emulsionit.
Pika 30 – Pajisje montuese për pastrimin e pahive elastike dhe shenjave në komunikacion, maksimumi 400 kg
Ky është një nga pozicionet që duhet kontrolluar veçanërisht në raport me paramasën. Në dokumentacionin e projektit parashihen sinjalizimi horizontal dhe vertikal, si dhe ruajtja e qarkullimit gjatë punimeve. Megjithatë, nuk rezulton nga përshkrimi i paramasës së shqyrtuar ndonjë pozicion i veçantë që përcakton pastrimin e pahive elastike me një pajisje të tillë të montueshme.
Për më tepër, kufizimi në peshë maksimale prej 400 kg mund të përjashtojë pajisje të tjera që kryejnë të njëjtin funksion.
Kërkojmë që kjo pajisje të largohet nga lista obligative nëse nuk lidhet me ndonjë punim konkret të kontratës, ose që të lejohet çdo pajisje ekuivalente që përmbush funksionin e kërkuar.
Pika 31 – Makinë për shpërndarjen e bitulit, me peshë 400–600 kg
Në paramasë parashihen punime të asfaltimit dhe spërkatje me emulsion, por duhet të sqarohet dallimi ndërmjet funksionit të kësaj makine dhe atij të kamionit me spërkatës për emulsion të kërkuar në Pikan 29.
Për më tepër, intervali i peshës prej 400–600 kg është i ngushtë dhe nuk është i qartë nëse pesha lidhet me produktivitetin ose cilësinë e shpërndarjes.
Kërkojmë që të përcaktohet funksioni teknik që duhet të kryhet dhe të lejohen pajisje ekuivalente për shpërndarjen uniforme të materialit përkatës, pa kufizim të panevojshëm të peshës.
Pika 32 – Gërryese e asfaltit, me peshë 16–18 ton
Gërryerja e asfaltit mund të jetë e nevojshme, pasi paramasa përfshin largimin e asfaltit ekzistues dhe prerjen e sipërfaqeve të asfaltuara. Megjithatë, duhet të sqarohet pse kërkohet një makineri e veçantë me peshë 16–18 ton dhe pse nuk lejohet një makineri tjetër e përshtatshme për sipërfaqet dhe sasitë e parapara.
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 16 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 33 – Gërryese e asfaltit, me peshë 6–8 ton
Kërkohet një makineri e dytë për gërryerjen e asfaltit, me interval të veçantë peshe. Dosja duhet të shpjegojë pse është e domosdoshme të sigurohen dy makineri të tilla dhe pse nuk mund të realizohen punimet me një makineri të përshtatshme, duke marrë parasysh sasitë, gjerësinë e punës dhe afatin e kontratës.
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 8 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 34 – Finisher për shtrirjen e asfaltit, me peshë 20.5–22.5 ton
Paramasa përmban shtresa të konsiderueshme të asfaltit, prandaj përdorimi i finisherit është i arsyeshëm. Megjithatë, kjo nuk e dëshmon se nevojitet patjetër një finisher me interval të caktuar prej 20.5–22.5 ton.
Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 20 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.
Pika 35 – Finisher për shtrirjen e asfaltit, me peshë 18.5–19.5 ton
Kjo kërkesë paraqet një kategori të dytë finisheri, me interval peshe prej vetëm 1 ton. Nuk është e qartë pse finisheri i Pikat 34 nuk do të ishte i përshtatshëm për të njëjtat punime ose pse nevojitet një makineri e veçantë me këtë peshë.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të arsyetojë nevojën për finisher të dytë me kapacitet te tille, nese arsyeton nevojshmerine, te largojë intervalin dhe te vendose nje minimum prej 18t.

Pika 36 – Finisher për shtrirjen e asfaltit, me peshë 15.5–17.5 ton

Edhe për këtë pozicion kërkohet finisher tjetër, me interval të veçantë peshe. Përderisa paramasa përcakton sipërfaqet dhe trashësitë e shtresave asfaltike, duhet të sqarohet se cilat punime kërkojnë detyrimisht një finisher të kësaj kategorie dhe pse nuk mund të përdoret një pajisje tjetër me kapacitet të përshtatshëm.

Kërkojmë që kërkesa të rishikohet, të hiqet kufizimi i panevojshëm i peshës dhe të lejohet pajisje ekuivalente për shtrirjen cilësore të asfaltit me min 15t.

Pika 37 – Finisher për shtrirjen e asfaltit, me peshë 4.5–6.5 ton

Kërkesa për një finisher të katërt, me peshë shumë më të ulët se tre kategoritë e tjera, duhet të arsyetohet në raport me punimet konkrete që kërkojnë këtë pajisje.

Nëse qëllimi është shtrirja e asfaltit në hapësira të ngushta, hyrje, lidhje ose zona të kufizuara, kjo duhet të përcaktohet sipas funksionit dhe gjerësisë së punës, jo vetëm përmes një intervali peshe.

Kërkojmë që nevoja për këtë finisher të veçantë të arsyetohet dhe të lejohet përdorimi i pajisjeve ekuivalente për shtrirjen e asfaltit në zonat përkatëse me min 4ton.

Pika 38 – Dy cilindra asfaltimi hekur–hekur, me peshë 7.5–8.5 ton

Përdorimi i cilindrave hekur–hekur për ngjeshjen e asfaltit është i zakonshëm, por kërkesa për dy cilindra me interval peshe prej vetëm 1 ton është e pa arsyeshme.

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 7 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 39 – Dy cilindra asfaltimi gomë–hekur, me peshë 7.5–8.5 ton

Edhe në këtë pozicion përcaktohet një interval shumë i ngushtë i peshës, në mëyrë krejtësishtë kundërligjore.

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 7 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 40 – Cilindër për asfaltim hekur–hekur, me peshë 4–5 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 3 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 41 – Cilindër për asfaltim gomë–hekur, me peshë 3–4 ton

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 3 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 42 – Dy cilindra vibrues me peshë maksimale 600 kg

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 600 kg, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 43 – Cilindër-rul me shtytës për shtrimin e rrugëve me xhemba dhe vibrues, me peshë 400–600 kg

Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 400t, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 44 – Makinë për vizatimin e vijave në asfalt, me peshë 2–2.5 ton

Paramasa përfshin sinjalizimin horizontal dhe vertikal, prandaj realizimi i vijëzimit

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

horizontal është pjesë e punimeve. Megjithatë, nuk është e qartë pse makina duhet të ketë peshë 2–2.5 ton,apo është vendosur vetëm për të ju përshtatur një OE të caktuar. Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 2 ton, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika i shënuar përsëri me nr. 44 – Kovë për përzierjen e betonit, me peshë 300–600 kg

Sa i përket pajisjes, paramasa përfshin punime të betonit në elemente të ndryshme të infrastrukturës. Megjithatë, nuk është e qartë pse kërkohet pikërisht një kovë për përzierjen e betonit që montohet në makineri, me peshë 300–600 kg, dhe pse nuk mund të përdoren metoda të tjera të përshtatshme të furnizimit dhe vendosjes së betonit. Kërkojmë largimin e këtij intervali të kapacitetit duke e zëvëndesuar me min 600kg, pasi që intervale të tilla kaq të ngushta kufizojnë konkurrëncen dhe favorizojnë /diskriminojnë OE të caktuar.

Pika 45 – Tri kamioneta Double Cabine, me ngarkesë të lejuar 1.2–1.4 ton

Kërkesa për tri kamioneta me konfigurim Double Cabine dhe kapacitet bartës të kufizuar në intervalin 1.2–1.4 ton nuk shoqërohet me arsyetim se pse nevojiten pikërisht tri automjete dhe pse kapaciteti bartës duhet të jetë brenda këtij intervali. Kërkojmë që numri dhe kapaciteti bartës i kamionetave të rishikohen në raport me nevojat reale të kantierit dhe të lejohen automjete ekuivalente që mundësojnë transportin e personelit dhe materialeve të nevojshme, sepse nuk ka asnjë arsyeshmëri për këtë kufizim kapaciteti.

Pika 46 – Tri kamioneta kiper, me peshë të barabartë ose më të madhe se 5 ton

Kërkesa për tri kamioneta kiper me peshë prej së paku 5 ton duhet të arsyetohet në raport me punimet konkrete dhe nevojën për transportin e materialeve në kantier. Duke qenë se në Pikan 8 kërkohen edhe dhjetë kamionë kiper me kapacitet minimal 10 mł, duhet të sqarohet pse nevojitet veçmas edhe kjo kategori prej tri automjetesh dhe çfarë funksioni të veçantë do të kryejnë. Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të arsyetojë numrin dhe kapacitetin e kërkuar, si dhe të lejojë pajisje ekuivalente për transportin e materialeve të nevojshme.

Pika 47 – Dy pajisje GPS për matje gjeodezike të terreneve

Paramasa parasheh shënimin e trasesë, sigurimin e pikave gjeodezike dhe matjet gjatë kryerjes së punimeve. Për këtë arsye, pajisjet për matje gjeodezike janë të lidhura me objektin e kontratës. Megjithatë, duhet të sqarohet pse kërkohen pikërisht dy pajisje GPS dhe cilat janë karakteristikat teknike minimale të nevojshme. Nëse qëllimi është sigurimi i matjeve të sakta dhe dokumentimit gjeodezik, kërkesa duhet të përcaktojë funksionin dhe saktësinë e nevojshme, pa kufizuar konkurrencën vetëm në një lloj pajisjeje. Kërkojmë që të arsyetohet numri prej dy pajisjesh dhe të lejohen instrumente gjeodezike ekuivalente që përmbushin saktësinë dhe kërkesat teknike të projektit.

Pretendimi 2

Kërkesa për angazhimin e një (1) ekonomisti me së paku pesë (5) vite përvojë pune dhe certifikime specifike në fushën e energjisë elektrike dhe politikave financiare Kundërshtojmë në tërësi këtë kërkesë, pasi angazhimi i një ekonomisti me pesë (5) vite përvojë pune, si dhe me certifikime specifike në menaxhimin e energjisë elektrike në ndriçimin publik SMART, ESRx – Reforma e Subvencionimit të Energjisë dhe Programim dhe Politika Financiare (FPP), nuk ka ndërlidhje të drejtpërdrejtë me natyrën, objektin dhe aktivitetet që përfshihen në një kontratë për ndërtimin e rrugëve. Është e paqartë se për çfarë qëllimi konkret kërkohet angazhimi i një profili të tillë profesional në realizimin e punimeve ndërtimore të rrugëve, çfarë përgjegjësish do të ketë

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

gjatë zbatimit të kontratës dhe në çfarë mënyre përvoja dhe certifikimet e kërkuara do të ndikojnë në cilësinë, sigurinë apo realizimin teknik të punimeve.
Për më tepër, kërkesa për certifikime kaq specifike, të cilat lidhen me menaxhimin e energjisë elektrike, subvencionimin e energjisë dhe politikat financiare, e jo me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, krijon dyshime serioze për proporcionalitetin dhe objektivitetin e kritereve të përcaktuara. Kjo nuk përbën një kërkesë të zakonshme apo të arsyeshme për një kontratë të kësaj natyre, por një kushtëzim të veçantë që mund të kufizojë ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që kanë kapacitetet reale për realizimin e punimeve.
Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë kërkesa që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që janë të domosdoshme për realizimin e saj, e jo të vendosë profile profesionale dhe certifikime që nuk kanë funksion të qartë në kuadër të punimeve të parapara.
Andaj, kërkojmë që kërkesa për angazhimin e ekonomistit dhe të gjitha certifikimet e lartcekura të largohen nga dosja e tenderit, pasi nuk janë të arsyetuara në raport me objektin e kontratës dhe paraqesin kufizim të panevojshëm dhe joproporcional të konkurrencës.
Pretendimi 3
Kundërshtojmë kërkesën për angazhimin e një (1) inxhinieri të diplomuar të elektroteknikës, i cili, përveç përvojës së përgjithshme profesionale prej së paku pesë (5) vitesh pas diplomimit dhe licencimit me kategorinë A nga OIRK, duhet të jetë edhe Auditor i Certifikuar i Energjisë në Ndriçimin Publik dhe të ketë menaxhuar së paku një (1) projekt të ndriçimit publik SMART.
Vlerësojmë se kërkesa e tillë është e tepruar dhe jo proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës, e cila ka për qëllim ndërtimin e rrugëve. Përfshirja e punimeve të ndriçimit publik në kuadër të projektit nuk e arsyeton domosdoshmërisht kërkimin e një profili kaq specifik profesional, i cili duhet të posedojë njëkohësisht edhe kualifikimin e auditorit energjetik, edhe përvojë në menaxhimin e projekteve SMART.
Në veçanti, certifikimi si Auditor i Energjisë në Ndriçimin Publik përfaqëson një kualifikim të specializuar, i cili nuk është domosdoshmërisht i nevojshëm për mbikëqyrjen dhe realizimin e punimeve të zakonshme të instalimit të ndriçimit publik. Po ashtu, kërkesa për përvojë në menaxhimin e projekteve SMART kufizon konkurrencën, duke përjashtuar inxhinierë të elektroteknikës të cilët kanë përvojë profesionale relevante në instalimin dhe realizimin e sistemeve të ndriçimit publik, por që nuk kanë menaxhuar projekte të këtij karakteri.
Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishikojë këtë kërkesë dhe ta përshtatë atë me objektin real të kontratës, duke kërkuar një inxhinier të diplomuar të elektroteknikës, me përvojë përkatëse në punime elektrike dhe ndriçim publik, si dhe licencimin profesional kur ai kërkohet sipas legjislacionit në fuqi, pa e kushtëzuar me certifikimin si Auditor i Energjisë dhe përvojën specifike në projekte SMAR
Pretendimi 4
Kundërshtojmë Kërkesën 6 dhe Dëshminë 6, përmes së cilave kërkohet që Operatori Ekonomik, së bashku me ofertën, të dorëzojë raportin e kalkulimit fotometrik të përgatitur në softuerin DIALux Evo ose ekuivalent, për trupin ndriçues të ofertuar, të nënshkruar nga një Auditor i Certifikuar për Ndriçim Publik dhe të vulosur nga Operatori Ekonomik.
Vlerësojmë se kjo kërkesë është e tepruar dhe joproporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës, e cila ka për qëllim ndërtimin e rrugëve dhe jo projektimin apo auditimin e sistemeve të ndriçimit publik. Përgatitja e një raporti të tillë kërkon angazhimin e një profesionisti me kualifikim të specializuar, si dhe realizimin e kalkulimeve të veçanta teknike që shkojnë përtej dëshmimit të karakteristikave dhe përputhshmërisë së produktit

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

të ofertuar.
Për më tepër, kërkesa për nënshkrimin e raportit nga një Auditor i Certifikuar për Ndriçim Publik krijon një kufizim shtesë për Operatorët Ekonomikë, pasi i kushtëzon ata me angazhimin e një kategorie të veçantë profesionisti, edhe pse përputhshmëria teknike e trupit ndriçues mund të dëshmohet përmes dokumentacionit teknik të prodhuesit, raporteve fotometrike të produktit dhe skedarëve përkatës IES/LDT. Gjithashtu, nëse Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar paraprakisht parametrat dhe kërkesat fotometrike që duhet të përmbushë ndriçuesi, atëherë verifikimi i përputhshmërisë mund të bëhet përmes dokumentacionit teknik përkatës, pa e obliguar secilin Operator Ekonomik të përgatisë një kalkulim të veçantë fotometrik dhe ta nënshkruajë atë përmes një Auditori të Certifikuar që në fazën e ofertimit. Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që Kërkesën 6 dhe Dëshminë 6 t'i rishikojë, duke larguar obligimin për dorëzimin e raportit të veçantë të kalkulimit fotometrik të nënshkruar nga Auditori i Certifikuar në fazën e ofertimit dhe duke mundësuar dëshmimin e përputhshmërisë së ndriçuesit përmes dokumentacionit teknik të prodhuesit dhe skedarëve fotometrikë përkatës IES/LDT.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net